



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 47 prot.

Kamëz, më 25. 5 .2026

V E N D I M
Nr. 40. Datë 25/5 2026
MBI

“DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” Z. ARIF HOTI”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.05.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.39 Datë 22.05.2026 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligj nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Vendimit nr. 33, datë 21.03.2024 të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Kamëz”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Dhënien e titullit "Qytetar Nderi" z. Arif Hoti, “Për kontributin e tij human në shërbim të bashkëjetesës, mirëkuptimit dhe pajtimit shoqëror, rolin e shquar në forcimin e solidaritetit dhe harmonisë sociale, si dhe për angazhimin e vazhdueshëm në mbështetje të komunitetit në Bashkinë Kamëz.”
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

